

ALVIN SARAÇI

**ROLI I KONSULLATËS VENECIANE TË DURRËSIT
NË MBROJTJE TË INTERESAVE EKONOMIKE TË VENECIES
NË FILLIM TË SHEK. XVIII**

Në fillimin e shek. XVIII, ndërkohë që tregtia veneciane po kthehej gjithnjë e më tepër në rajonale, një vend i vogël si Shqipëria do të ishte partneri kryesor në tregtinë me Venecien¹.

Pas mbarimit të Luftës së Moresë (1684-1699) dhe Traktatit të Karlovicit (Sremski Karlovcit, 16-26 janar 1699), autoriteti venecian për tregtinë i Pesë të Urtëve në një relacion drejtuar doxhës së Venecies vërente se Shqipëria një vend “opulente di nogotio”, ku kalonte një vëllim i madh i tregtisë, ishte kthyer në një udhëkryq të mallrave nga i gjithë Ballkani (Maqedonia, Greqia, Transilvania, Vllahia, Moldavia etj.).²

Në fakt, rolin kryesor e kishte porti i Durrësit vendkalim i mallrave dhe tregtarëve nga Shkodra, Elbasani, Voskopoja, Tirana, Kavaja, Ohri dhe Shkupi, Kosturi, Siatista, Janina, Arta dhe Selaniku, Arvanitochori i Tërnovës (ngulim shqiptar në Bullgari) dhe i prijësve me origjinë shqiptare të Principatave Rumune e Moldave³. Sipas raportit të konsullit

¹ Regjistrat doganorë të Arkivave Shtetërorë të Venecies sidomos ato që i përkasin gjysmës së dytë të shek. XVIII e dëshmojnë këtë nëpërmjet shifrave.

² “opulente di nogotio”, *Archivio dello Stato di Venezia* (më tej: ASV), Cinque Savi alla Mercanzia (më tej: CSM), 2 Serie (më tej: 2°S.), busta (më tej: b.) 28, 28 maj 1699; Gelina Harlaftis, “International Business of the Southeastern Europe and the Eastern Mediterranean, 18th Century: Sources, Methods and Interpretative Issues”, në *Dove va la Storia Economica?: Metodi e Prospettive, Sec. XIII-XVIII – Where is economic history going? Methods and Prospects from the 13th to the 18th Centuries*”, *Atti della “Quarantadesima Settimana di Studi”, 18-22 aprile 2010*, nën kujdesin e Francesco Ammannati, Prato, Fondazione Istituto Internazionale di Storia Economica “F. Datini”, Firenze: Firenze University Press, 2011, f. 408.

³ ASV, CSM, 2°S., b. 28, 25 shtator 1704; Nikos G. Svoronos, *Le commerce de Salonique au XVIII siècle*, Paris: Presses universitaires de France, 1956, f. 193; *Dokumente të shekujve XVI-XVIII për historinë e Shqipërisë*, vëll. IV (1675-1699), përgatitën për botim Injac Zamputi, Selami Pulaha, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: 1990, dok. nr. 228, 8 shkurt 1699, f. 476-478; Cristian Luca, “Greek and Aromanian merchants protagonists of the trade relations between Transylvania, Wallachia, Moldavia and the Northern Italian Peninsula

francez të Durrësit, Balthasar Le Comte, në Durrës ishin të pranishëm rreth njëqind tregtarë, të cilët përfaqësoheshin në Venecie nga korrespondentët e tyre⁴.

Në shek. XVII-XVIII, qendrat ekonomike u zhvendosën në Mesdheun Verilindor. Nga fundi i shek. XVII, autoriteti venecian i Pesë të Urtëve për Tregtinë vuri re se nga të gjitha rrugët tregtare të Perandorisë Osmane, ku ishin selitë e konsullatës veneciane, vetëm Durrësi dhe Smirne (Izmiri) ishin dy portet ku tregtia me Venecien po ecte me ritëm të mirë⁵.

Në vitin 1594, tregtari hebre Daniel Rodriga o Rodriguez u propozoi autoriteteve veneciane Rrugën Tregtare të Durrësit (la scala di Durazzo) si rrugë kalimi tranzit për tregtinë e Ballkanit me Venecien, ashtu siç kishte realizuar më parë në vitin 1592 projektin e Rrugës Tregtare të Splitit (la scala di Spalato) për tregtinë ndërmjet Venecies dhe Perandorisë Osmane⁶.

Megjithatë, konsullata veneciane e Durrësit u hap më 1671 dhe kishte nën juridiksionin e saj portet e Tivarit, Shirgjrit, Shëngjinit, Vlorës dhe Sajadhës (la scala dell'Albania) dhe nuk përfshinte vetëm portin e Ulqinit⁷. Kjo do të kontribuonte që tregtia ndërmjet porteve shqiptare dhe Venecies të merrte një trajtë të mirëorganizuar dhe do të nxirrte në pah Durrësin si një port të rëndësishëm për shkëmbimet tregtare ndërkombëtare. Kjo për faktin se rrjetet tregtare dhe tregtia lokale ndërthureshin me tregtinë në shkallë të gjerë *micro* e *macro*⁸. Në të

(second half of the 17th –first half of the 18th Century)”, në *Transylvanian Review*, XIX, Supplement nr. 5, Cluj-Napoca Romania: 2010, f. 313-316.

⁴ *Dokumente të shekujve XVI-XVIII ...*, vëll. 4, përg. I. Zamputi, S. Pulaha, dok. nr. 228, 8 shkurt 1699, f. 476-478.

⁵ Në versionin origjinal thuhet: «pare che abbia avuto una miglior piega et inclinazione al negozio» ASV, CSM, 2° S., b. 28, 28 prill 1699.

⁶ Riccardo Calimani, *Storia del Ghetto di Venezia*, Milano: Mondadori, 2014, f. 191-192; Renzo Paci, “La «Scala» di Spalato e la politica veneziana in Adriatico”, në *Quaderni storici delle Marche*, vol. 5, 13, Bologna: Società editrice Il Mulino S.P.A., 1970, f. 48-105.

⁷ ASV, CSM, 2° S., b. 27/bis; Rosana D’Alberton, “Tra sanita e commercio: il difficile ruolo del lazaretto veneziano alla scala di Spalato”, në *Studi Veneziani*, n. s. XXXIX, Pisa, Roma: Istituti editoriali e poligrafici internazionali, 2000, f. 265.

⁸ Maria Fusaro, “Les Anglais et les Grecs, Un réseau de coopération commerciale en Méditerranée vénitienne”, në *Annales, Histoire, Sciences Sociales*, 58e Année, No. 3, Paris: EHESS, May - Jun., 2003, f. 608.

njëjtën periudhë, në vitin 1673 u ngrit në Durrës konsullata franceze dhe pas vitit 1680 u hap edhe selia konsullore e Holandës⁹.

Konsullatat u krijuan duke u bazuar mbi marrëveshjet (kapitulacionet) ndërmjet Venecies dhe fuqive të tjera tregtare me Perandorinë Osmane që konfirmonin ato të mëparshmet.¹⁰ Kështu, ngritja e konsullatës veneciane u krye mbi bazën e marrëveshjes së shkurtit 1670, (e cila bazohej mbi kapitulacionin e parë të vitit 1481) që u firmos nga Mehmeti IV për Alvisë Molin, ambasador i jashtëzakonshëm i Venecies në Stamboll¹¹. Ndërsa konsullata franceze në Durrës u bazua mbi privilegjet tregtare që iu dhanë Francës nga Perandoria Osmane, të cilat u rinovuan në fund të majit 1673 dhe bazoheshin mbi marrëveshjen e vitit 1535 ndërmjet Mbretit të Francës, François I e Sulltan Sulejmanit I, e cila përmbante edhe nenin 3 që i lejonte francezëve ngritjen e ambasadës në Stamboll dhe të konsullatave në vendet e Mesdheut Lindor, të cilat do të merreshin me çështjet tregtare¹². Së fundi, konsullata holandeze e Durrësit u ngrit pas marrëveshjes së vitit 1680, që mbështetej mbi kapitulacionin e parë të vitit 1612¹³. Njëpërmjet tyre, këto vende kishin një njohje si kombe brenda Perandorisë Osmane dhe u sanksionoheshin privilegjet tregtare që lidheshin me taksën doganore, e cila rregullonte marrëdhëniet tregtare.

Sipas Vera Costantini-t, e gjendur përballë fuqisë tregtare të Republikës së Venecies në Mesdhe, Perandoria Osmane hyri në rrjetet

⁹ Luan Rama, *Konsullatat franceze në Shqipëri gjatë shekujve XVII-XIX*, Tiranë: Bota shqiptare, 2019; Alvin Saraçi, *Tregtia adriatike e Shkodrës me Republikën e Venecies në shekujt XVII e XVIII*, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Tiranë: 2018, f. 119-130.

¹⁰ Suraiya Faroqhi, *The Ottoman Empire and the world around it*, New York, London: I. B. Tauris, 2004, f. 3.

¹¹ Milos Jačov, "Gli accordi commerciali tra l'Impero ottomano e la Repubblica di Venezia", *Rapporti diplomatici e scambi commerciali nel Mediterraneo, Atti del Convegno Internazionale di studi (Fisciano, 23-24 ottobre 2002)*, Salerno, nën kujdesin e Mirella Manfrici, Università degli Studi di Salerno, Rubbettino Editore, 2004, f. 106.

¹² Paul Célestine Mason, *Histoire du Commerce Français dans le Levant au XVIII siècle*, Paris: Hachette&C, 1898, f. 214; François-Emmanuel Guignard comte de Saint-Priest, *Mémoires sur l'ambassade de France en Turquie et sur le commerce de France en Turquie et sur le commerce des français dans le Levant*, vol. 2, Paris: Ernest Leroux, 1877, f. 278-279.

¹³ Mehmet Bulut, *Ottoman-Dutch Economic Relations in the Early Modern Period 1571-1699*, Ankara: Hilversum, 2001, f. 116-118.

tregtare dypalëshe me një partner tregtar të privilegjuar dhe me përvojë si Venecia, në mënyrë që t'i shfrytëzonte sa më mirë këto shkëmbime për vlerësimin e burimeve të saj ekonomike¹⁴. Por, nga ana tjetër, hapja dhe roli arbitrar i kapitulacioneve të Portës ndaj fuqive tregtare europiane si Franca (1535), Anglia (1580) dhe Holanda (1612), nuk ishte vetëm një mënyrë për të patur të ardhura të konsiderueshme nga tregtia e mallrave që kalonin në doganat e saj nga zona të ndryshme ku përfshihej edhe Ballkani, hapje që sado që nuk ndikoi në dekadencën e tregtisë veneciane e dobësoi hegjemoninë tregtare veneciane. Madje, duke patur parasysh faktin e kufijve që kalonin mes dy vendeve, shtrirja e tregtisë veneciane me Shqipërinë, kishte krijuar marrëdhënie të ngushta dhe e kishte rritur rolin e tregtisë së jashtme të Shqipërisë me fuqitë e tjera tregtare europiane.

Në shek. XVIII, konsullata veneciane dhe franceze e Durrësit bënin pjesë ndër 14 konsullatat e Lindjes që përfshinin Ballkanin dhe Mesdheun Lindor¹⁵. Konsullata veneciane e Durrësit përbëhej nga konsulli, nënkonsulli ose dragomani, kopisti (shkruesi), kancelari, agjentët konsullorë të doganave, korrierët (postierët), jeniçerët (rojet) dhe këshilli konsullor (ku bënin pjesë kapitenët e anijeve) të cilët kishin të gjithë një funksion të veçantë brenda konsullatës¹⁶.

Për venecianët diplomacia dhe tregtia ishin të lidhura në mënyrë të pandashme. Kjo mund të japë një shpjegim përse ligjet veneciane për tregtinë hartoheshin nga Pesë të Urtët dhe miratoheshin nga Senati, të

¹⁴ Vera Costantini, *Il Sultano e l'isola contesa, Cipro tra eredità veneziana e potere ottomano*, Torino: Utet, 2009, f. 28-32.

¹⁵ Maria Aglietti, *L'istituto consolare tra Sette e Ottocento. Funzioni istituzionali, profilo giuridico e percorsi professionali nella Toscana granducale*, Pisa, ETS, 2012, f. 216; Gérard Poumarède, "Naissance d'une institution royale: les consuls de la nation française en Levant et en Barbarie aux XVIe et XVIIIe siècles", *Annuaire-Bulletin de la Société de l'histoire de France*, Paris : Société de l'Histoire de France, Editions de Boccard, 2001, f. 66.

¹⁶ Maria Aglietti, *L'istituto consolare tra Sette e Ottocento. Funzioni istituzionali, profilo giuridico e percorsi professionali nella Toscana granducale*, Pisa: ETS, 2012, f. 216; Gérard Poumarède, "Naissance d'une institution royale: les consuls de la nation française en Levant et en Barbarie aux XVIe et XVIIIe siècles", *Annuaire-Bulletin de la Société de l'histoire de France*, Paris: Société de l'Histoire de France, Editions de Boccard, 2001, f. 66.

cilët kishin si kompetencë të tyre edhe zgjedhjen e konsujve¹⁷. Më pas, ato i dërgoheshin konsullit së bashku me udhëzimet, i cili duhet t'i përmbahej dhe t'i zbatonte. Në disa raste këto ligje afishoheshin si shpallje në portet ku gjendeshin konsullatat, pra dhe në Durrës. Sipas Steensgaard, politika ekonomike veneciane në të gjitha konsullatat veneciane zhvillohej nga Pesë të Urtët dhe zbatoheshin prej konsullit nga njëra anë, dhe nga krerët e tregtarëve e shtetasit venecianë në Durrës, nga ana tjetër¹⁸.

Konsulli venecian mbronte të drejtat e shtetasve venecianë të pranishëm në Durrës, kryesisht tregtarë dhe marinarë, ku përfshiheshin edhe subjektet që vinin nga portet që ishin pjesë e Republikës së Venecies si dhe shtresën e mesme të korrespondentëve (*commissionari*) jo vetëm venecianë, por edhe nga Janina, Arta dhe Ishujt Jonikë, në duart e të cilëve ishte një rrjet i gjerë tregtar, të cilët ishin gjithashtu edhe krerët e tregtarëve si dhe të huajt që përfaqësonin ose punonin për administratën konsullore veneciane duke përfshirë këtu dhe shqiptarët.

Misioni i konsujve venecianë lidhet kryesisht me zgjerimin e raporteve tregtare dhe administrimin e tyre¹⁹. Përsa i përket misionit të tij diplomatik, disa autorë e kanë parë atë si një rol politik²⁰. Konsulli është gjithashtu një person që përfaqëson ligjin²¹. Ai duhet të njihte situatën në të cilën gjendej tregtia, politika dhe të mblidhte informata lidhur me sëmundjet dhe epidemitë, të regjistronte numrin e anijeve të huaja dhe veneciane që kalonin në portin e Durrësit, të merrej me hartimin e policë-

¹⁷ Antonio Trampus, "Le diplomate vénitien entre les XVIe et XVIIIe siècles: statut, rôles et fonctions", në *Le diplomate en question (XIe-XVIII siècles)*, ed. Eva Pibiri, Guillaume Poisson, Lausanne: University of Lausanne, 2010, f. 121.

¹⁸ Niels Steensgaard, "Consuls and nations in the Levant from 1570 to 1640", në *Scandinavian Economic History Review*, 15, 1-2, London: Routledge, Taylor & Francis, 1967, f. 25.

¹⁹ *Po aty*, f. 14; Jörg Ulbert, "Introduction. La fonction consulaire à l'époque moderne: définition, état des connaissances et perspectives de recherche", në Gérard Le Bouëdec, Jörg Ulbert, *La fonction consulaire à l'époque moderne: affirmation d'une institution économique et politique, 1500-1770*, Rennes: Presse Universitaires de Rennes, 2006, f. 13.

²⁰ Adolfo Maresca, *Récueils des cours – Collected courses of the Hague Academy of International Law*, vol. 134, Leyden: A. W. Nijthoff, 1972, f. 116; shih "Qui est le diplomate au XVIIIe siècle?", në A. Trampus, *Le diplomate vénitien entre les XVIe et XVIIIe siècles...*, f. 130-131.

²¹ Shih "Introduction" në P. C. Mason, *Histoire du commerce français...*, f. xij.

ngarkesave të anijeve tregtare dhe të pajiste anijet e huaja tregtare që lundronin në Adriatik me lejekalim venecian etj²².

Konsujt e Durrësit zgjidheshin nga Pesë të Urtët dhe më pas miratoheshin nga Senati venecian me 2/3 e votave²³. Në zgjedhjen e konsullit kishin një peshë të veçantë edhe kërkesat e dërguara autoritetit të Pesë të Urtëve për Tregtinë nga ana e kandidatëve, ku renditeshin meritat e tyre²⁴.

Pas Traktatit të Karlovicit që shënoi hapjen e tregtisë ndërmjet Venecies dhe Perandorisë Osmane, konsulli venecian i Durrësit, Francesco d'Andria, i cili vinte nga një familje gjenoveze nga ishulli grek i Scios (Kios), kishte dorëzuar ndërkohë emrat e kandidatëve për postin e konsullit të ardhshëm të Durrësit që do të zgjidheshin nga Pesë të Urtët për Tregtinë: Giorgio Cumano, Iseppo Vellai, Niccolò Marco Bruni, Nicola Pulimeno e Francesco Soffietti²⁵.

Giorgio Cumano ishte më favoriti për këtë post. Së pari, ai vinte nga ishulli i Kretës, që kishte qenë pjesë e Venecies deri në vitin 1669, prandaj preferohej si shtetas venecian, rridhte me sa duket nga një familje shqiptaro-helene sepse e njihnte mirë gjuhën shqipe dhe kishte patur një përvojë të mëparshme si konsull në Arkadia të Greqisë, e cila kishte qenë e pakëndshme, sepse ai kishte humbur pasurinë²⁶. Në peticionin që i dërgon Pesë të Urtëve si kandidat për postin e konsullit, ai përshkruan karrierën e tij konsullore që në periudhën kur ishte nënkonsull dhe dragoman i konsullit Dimiter Taxiano më 1674 dhe drejtonte konsullatën

²² ASV, CSM, 2. S, b. 28, 2 maj 1699. Ligji i 19 gushtit 1671 i jepte konsullit të Venecies në Durrës kompetencat e “magistrato alla estesa della patente”.

²³ Maria Pia Pedani Fabris, “Consoli veneziani nei porti del Mediterraneo in età moderna” në ed. R. Cancila *Mediterraneo in armi (sec. XV-XVIII)*, Palermo: Associazione Mediterranea, 2007, f. 178-179.

²⁴ Umberto Signori, “Supplier pour le consulat. Entre défense des 'intérêts personnels et service fidèle des consuls vénitiens dans le Levant ottoman (1670-1703)”, në *Cahiers de la Méditerranée*, 98, Rennes: Presse Universitaires de Rennes, 2019, f. 34.

²⁵ ASV, CSM, 2° S., b. 28, 28 maj 1699.

²⁶ *Po aty*, CSM 2° S., b. 28, 4 maj 1699; Cristian Luca, “The Dynamics of the Commercial Activity in the Ottoman Port of Durazzo during the Consulate of Zorzi (Giorgio) Cumano (1699 -1702)”, në *Small is Beautiful?, Interlopers and Smaller Trading Nations in the Pre-Industrial Period, Proceedings of the XVth Congress of Economic History Utrecht (Netherlands) 2009*, VSWG-Beihefte, 213, nën kujdesin e Markus A. Denzel, Jan de Vries, Philipp Robinson Rössner, Stuttgart: F. Steiner, 2011, f. 189.

veneciane pas largimit të tij²⁷. Postin e dragomanit e kishte fituar sepse përveç greqishtes dhe shqipes, kishte njohuri shumë të mira edhe të gjuhës italiane, veneciane, osmane dhe sllave²⁸. Gjithashtu, në mbarim të luftës së Moresë më 1699, ai nuk i kishte lejuar raguzanët, rivalët e tregtisë veneciane që të zbarkonin mallra importi në Durrës dhe i kishte dhënë të drejtën që të përdornin si rrugë tregtare portin e Kotorrit “la scala di Catarro”²⁹. Së fundi, në periudhën kur ishte konsull Thoma Kotoni (Tommaso Cottoni) nga Arta, ai mbante postin e nënkonsullit, por me shpërthimin e Luftës Veneto-Turke të Moresë (1684), ai ishte detyruar të largohej drejt Venecies³⁰. Sidoqoftë, ai nuk flet për merita të tjera siç ishte rasti i ndërmjetësimit në Venecia për lirimin e tregtarëve të Perandorisë Osmane dhe kthimin e tij më 1688 për të marrë postin e konsullit të Holandës në Durrës³¹.

Giorgio Cumano kishte edhe mbështetjen e korrespondentëve dhe tregtarëve të mëdhenj të shtresës së mesme që tregonin nëpërmjet portit të Durrësit, të cilët ishin kryesisht nga Janina dhe Arta³². Kjo, sepse edhe ai bashkë me nipin e tij kishin qenë gjithashtu korrespondentë të tregtarëve të Voskopojës në Venecie, të cilët me rastin e zgjedhjes së tij i dërguan një peticion Pesë të Urtëve për Tregtinë më 1 shtator 1700, ku shprehnin përkrahjen e tyre³³.

Konsulli i sapozgjedhur i Venecies, Giorgio Cumano arrin në Durrës më 9 prill 1700 dhe një ditë më pas fillon letërkëmbimi i tij me Pesë të Urtët³⁴.

Pas zgjedhjes së tij në Venecie, konsullit venecian i duhej të kishte edhe njohjen nga Porta e Lartë me anë të një *berati*, prandaj i duhej të nisej menjëherë për në Stamboll, ku me gjithë vonesat, arrin ta sigurojë

²⁷ ASV, CSM 2° S., b. 28, 4 maj 1699; A. Saraçi, *Tregtia adriatike e Shkodrës...*, f. 144, 178.

²⁸ *Po aty*.

²⁹ ASV, CSM, 2° S., b. 28, 4 maj 1699.

³⁰ A. Saraçi, *Tregtia adriatike e Shkodrës...*, f. 145, 161.

³¹ *Po aty*.

³² ASV, CSM, 2° S., b. 28, 15 maj 1699.

³³ *Po aty*, CSM, 2° S, b. 28, 1 shtator 1700; C. Luca, “The Dynamics of the Commercial Activity...”, f. 179.

³⁴ *Dokumente mbi Shqipërinë në shekullin XVIII: letrat e konsujve venedikas të Durrësit*, vëll. I (1696-1707), përgatiti për botim Zija Shkodra, Akademia e Shkencave të RPS të Shqipërisë, vëll. I, Tiranë: 1975, dok. nr. 2, 10 prill 1700, f. 31-32; ASV, CSM, 1° S., b. 661, 10 prill 1700.

atë në tetor me ndihmën e ambasadorit të jashtëzakonshëm venecian në Stamboll, Lorenzo Soranzo³⁵.

Megjithatë, periudha si konsull do të kishte një kohëzgjatje të shkurtër deri më 29 nëntor 1702, vit i vdekjes së tij. Posti do t'i kalonte përkohësisht vëllait, Giovanni Cumano dhe nipit Giorgio, djali i Emmanuele Cummano-s, i cili do të përfaqësonte përkohësisht konsullatën veneciane në Durrës, në pritje të vendimit të Pesë të Urtëve për njohjen e tij deri në zgjedhjen e konsullit të ri³⁶.

Meqenëse konsullata veneciane kishte qëndruar e mbyllur deri në hartimin e Traktatit të Karlovicit që kishte hapur tregtinë ndërmjet Venecies dhe Perandorisë Osmane, që në fillim të aktivitetit të tij konsullor, konsulli i Venecies në Durrës Giorgio Cumano e dinte se venecianët duhet të rimerrnin në dorë tregtinë, e të përballeshin me konkurrencën e konsullatave franceze dhe holandeze të Durrësit, dhe në një shkallë më të vogël me atë raguzane³⁷.

Nënkonsullata franceze e Durrësit ishte hapur tashmë, siç del nga letra e datës 6 maj 1673 nga ambasadori francez në Stamboll, Charles Olivier Nointel (1670-1679) për Jean Baptiste Colbert-in, Sekretar i Shtetit dhe i Marinës franceze, ku flitet për një ankesë që tregtarët hebrenj, grekë dhe armenë i kishin drejtuar Portës lidhur me një kapiten venecian dhe nënkonsullin francez të Durrësit³⁸. Tregtia e konsullatës franceze në Durrës zhvillohej me tre portet e Adriatikut që nuk kontrolloheshin nga Republika e Venecies: Ankona (porti i Papës), Ragusa (Dubrovniku), Fiume (Rijeka – Kroaci, asokohe port hungarez) me portin francez të Marsejës³⁹.

³⁵ ASV, CSM, 2°S, b. 28, 20 dhjetor 1700; *po aty*, dok. nr. 4, 17 qershor 1799, f. 34-35; dok. nr. 6, 6 tetor 1700, f. 36-37.

³⁶ ASV, Bailo a Costantinopoli (më tej: BC), Lettere, b. 167, dok. nr. 11, 29 nëntor 1699.

³⁷ Stavri Naçi, "Rreth tregtisë së Sanxhakut të Shkodrës me Republikën e Venedikut gjatë shek. XVIII", në *Buletini i Universitetit të Tiranës*, Tiranë: 1963, nr. 1, f. 14-15; Zija Shkodra, "Problemi i tregut shqiptar në shek. XVIII", në *Studime historike*, XX, nr. 3, Tiranë: 1966, f. 63.

³⁸ *Correspondance consulaire des ambassadeurs de France à Constantinople: 1668-1708: inventaire analytique des articles A. E B1 376 à 385*, përgatiti për botim Raia Zaimova, Philippe Henrat, Pierrefitte-sur-Seine, Centre Historique des Archives Nationales, Paris: 1999, f. 343, 6 maj 1673, f. 29.

³⁹ *Dokumente mbi Shqipërinë në shekullin XVIII...*, përg. Z. Shkodra, vëll. I, dok. nr. 2, 10 prill 1700, f. 31-32 dhe dok. nr. 5, viti 1700, f. 34-35; ASV, CSM, 1°S., b. 661, 10 prill 1700.

Francezët kishin mundur të monopolizonin disa mallra si gruri, vaji etj., dhe i kishin rritur çmimet e tyre, si në rastin e grurit që kushtonte 3 realë për 100 okë*, duke e çuar numrin e anijeve franceze të ngarkuara me grurë që niseshin nga Shqipëria në njëzet⁴⁰.

Ndërkohë, Lufta e Moresë e kishte rënduar gjendjen e lundrimit të anijeve që arrinin nga qyteti kotorras i Perastit, të cilët kishin siguruar të ardhura të pakta nga ngarkesat me mallra të tregtarëve të Durrësit. Vakumi i lënë prej tyre, ishte shfrytëzuar mirë nga anijet tregtare ulqinake, të cilat ishin vënë në shërbim të tregtisë që kalonte nëpërmjet konsullatës franceze dhe holandeze në Durrës.

Kështu, në vitin 1696, konsulli francez i Durrësit, Balthasar Le Comte kishte lidhur një kontratë me pronarin e një anijeje nga Ulqini, të cilën e kishte pagëzuar me emrin “Saint Jean Baptiste”, kapiteni i të cilës do të ishte francezi Joseph Isnard ose Iseppo, siç shfaqet në dokumentet veneciane, i cili do të ngarkonte mallra për llogari të Charles & Brousson, të Kompanisë së Mesdheut të Marsejës⁴¹ dhe dispononte 7000 cantari (kandarë)⁴² nga navllimi (qiradhënia e anijes)⁴³. Me anë të kësaj anijeje, ai do të zhvillonte tregtinë ndërmjet Durrësit dhe Venecies në një periudhë të vështirë për tregtinë veneciane për shkak të luftës së Moresë⁴⁴.

Në prag të Traktatit të Karlovicit, autoritetet veneciane për tregtinë menduan si të dobishme njohjen e të drejtës për kapitenët perastinë që të lidhnin kontrata navlloje me tregtarët venecianë, shqiptarë dhe të huaj që tregtonin me anë të konsullatave të tjera të pranishme në portin e

* 1 okë ishte e barabartë me 1.5 kg.

⁴⁰ *Po aty*, dok. nr. 14, 27 nëntor 1700, f. 57.

⁴¹ P. C. Mason, *Histoire du Commerce Français...*, f. 193-194; Jean Reynaud, “Joseph Fabre et les industries de la faïence et de la soie”, në *Marseille*, S. 3, nr. 9, Marseille: prill 1950, f. 33-40. Pierre Charles ishte një nga nga 15 themeluesit e Kompanisë Mesdhetare të Marsejës më 21 shtator 1685, që ishte nën drejtimin e Joseph Fabre, e cila u krijua kryesisht për zhvillimin e manifakturës dhe tregtinë e veshjeve, stofrave dhe pëlhurave franceze me Lindjen.

⁴² Maria Giagnacovo, *Appunti di metrologia mercantile genevose: un contributo della documentazione aziendale Datini*, Firenze: Firenze University Press, 2014. Cantaro (kandar) është një njësi matëse e barabartë me 150 libra ose 47-52 kg, f. 97.

⁴³ ASV, CSM, b. 661, n. 1, 9 korrik 1700; *Arkivi i Institutit të Historisë* (më tej: *AIH*), *Arkivi i Venedikut* (më tej: *V.*) – 1, “Konsujt e Durrësit”, dok. nr. 1, 9 korrik 1700; *Dokumente mbi Shqipërinë në shekullin XVIII...*, përg. Z. Shkodra, vëll. I, dok. nr. 1, 9 korrik 1696, f. 30-31.

⁴⁴ *Po aty*.

Durrësit. Pesë të Urtët e shpallën këtë ligj edhe pranë ambasadorit venecian në Paris⁴⁵. Nga ana tjetër, perastinët i dërguan një peticion ambasadorit francez në Venecia, më 23 janar 1699, duke e vënë në dijeni se Venecia u kishte dhënë monopolin e transportit të të gjitha mallrave që kalonin në portin e Durrësit, përfshirë edhe ato që do të kalonin nëpërmjet konsullatës franceze⁴⁶. Për këtë çështje u informuan jo vetëm autoritetet më të larta franceze për tregtinë, por edhe vetë mbreti.

Një situatë e tillë do të ishte preludi i një rivaliteti të vazhdueshëm ndërmjet marinarëve perastinë dhe ulqinakë në portin e Durrësit për të siguruar transportin e mallrave me anijet e tyre tregtare.

Një fakt tjetër që e shtyu komunitetin perastin për t'iu drejtuar ambasadorit të jashtëzakonshëm të Venecies, Lorenzo Soranzo që ta zgjidhte çështjen me ambasadorin francez në Stamboll ishte se francezët po tentonin të tërhiqnin edhe vetë kapitenët e anijeve perastine që prisnin radhën për t'u ngarkuar në portin e Durrësit, duke u ofruar përparësi dhe ndërrimin e flamurit venecian me atë francez nëse transportonin mallra me anë të konsullatës franceze⁴⁷. Kjo për faktin se numri i anijeve perastine ishte më i madh se ngarkesat me mallra që kalonin me anë të konsullatës veneciane në portin e Durrësit⁴⁸.

Sipas udhëzimeve që kishte, konsulli venecian nuk duhet të lejonte që anijet veneciane të ndërronin flamurin me atë të konsullatave të tjera. Prandaj, lidhur me çrregullimet që kishin ndodhur me anijen tregtare perastine në portin e Durrësit, Giorgio Cumano zotohej para Pesë të Urtëve me letrën e 18 qershorit 1700, se do të vinte rregull në lundrimin venecian⁴⁹.

Në vitin 1700, Venecia kishte destinuar gjashtë anije perastine në portin e Durrësit për ngarkesat e rregullta të mallrave, pa llogaritur anijet me drithëra⁵⁰. Kapitenët e anijeve dhe tregtarët kishin firmosur kontrata qiraje për transportin e mallrave në Venecia ose në Durrës përpara konsullit venecian të Durrësit (i cili në këtë rast luante dhe rolin e

⁴⁵ ASV, CSM, 2° S., b. 28, 23 janar 1699.

⁴⁶ *Po aty*, CSM, reg. 19-20, 23 janar 1699, f. 580; Pëllumb Xhufi, *Shekulli i Voskopojes (1669 -1769)*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë: Toena, 2010, f. 100-101.

⁴⁷ *Dokumente mbi Shqipërinë në shekullin XVIII...*, përg. Z. Shkodra, vëll. I, dok. nr. 3, 1 qershor 1700, f. 32-33.

⁴⁸ *Po aty*, dok. nr. 5, viti 1700, f. 36.

⁴⁹ *Po aty*, dok. nr. 4, 18 qershor 1700, f. 35.

⁵⁰ *Po aty*, f. 34-35.

noterit), të cilat ruheshin nga kancelari në arkivin e konsullatës. Pra, transporti i mallrave zhvillohej në mënyrë të programuar dhe në rastet kur numri i ngarkesave ishte më i madh, dërgoheshin anije shtesë.

Ishte krijuar gjithashtu këshilli i kapitenëve dhe i pronarëve të anijeve veneciane pranë konsullit venecian të Durrësit, që mblidhej bashkë me konsullin venecian, të cilit i përcilleshin të gjitha kërkesat dhe vërejtjet që kishin të bënin me lundrimin venecian⁵¹.

Dukej që në fillim se diplomacia veneciane do të ishte shumë aktive dhe po i kalonte një nga një pengesat që haste tregtia veneciane përsa i përket taksave më të larta në krahasim me fuqitë e tjera tregtare. Në Traktatin e Karlovicit, taksa doganore për shkëmbimet tregtare ndërmjet Venecies dhe Perandorisë Osmane në doganat e perandorisë zbriti nga 8 % në 5%⁵². Kjo dëshmohej edhe nga letra e konsullit të Venecies në Durrës, Francesco D'Andria, i cili njoftonte për uljen e taksës doganore pas paqes së nënshkruar. Megjithatë, taksa doganore e Perandorisë Osmane për francezët, holandezët dhe anglezët ishte 3%, pra edhe më e ulët⁵³. Falë bashkëpunimit të ngushtë të konsullit venecian të Durrësit me ambasadorin e jashtëzakonshëm në Stamboll, Lorenzo Soranzo dhe qëndrimin për një kohë të gjatë të Giorgio Cumano-s në kryeqytetin osman, tregtia veneciane do të vihej në pozita të barabarta me atë të vendeve me përfaqësi konsullore në Durrës. Përsa i përket taksës doganore, e cila megjithëse me akord dypalësh ishte 5%, pas marrëveshjes ndërmjet konsullit të Venecies në Durrës, me doganierët lokalë të portit, u vendos që të zbriste në 3%⁵⁴. Kjo konfirmohet edhe në letrën që Osmani, kryedoganieri i Durrësit i dërgonte Pesë të Urtëve, ku shprehet dëshira për të nxitur ardhjen e mallrave nga Venecia⁵⁵. Ai pohon se venecianët do të konsideroheshin si “frëngët” përsa i përket taksës doganore prej 3%, e cila vlente në të gjithë Perandorinë Osmane.

⁵¹ ASV, CSM, 1° S., b. 661, 1 qershor 1700; *AIH*, V-1, “Konsujt e Durrësit”, 1 qershor 1700.

⁵² C. Luca, “The Dynamics of the Commercial Activity...”, f. 180.

⁵³ ASV, CSM, 2° S., b. 28, pjesa 2, 28 prill 1699; Robert Mantran, *Istanbul dans la seconde moitié du XVIIe siècle. Essai d'histoire institutionnelle économique et sociale*, Paris: Maisonneuve, 1962, f. 526.

⁵⁴ *Dokumente mbi Shqipërinë në shekullin XVIII...*, përg. Z. Shkodra, vëll. I, dok. nr. 6, 6 tetor 1700, f. 36-37.

⁵⁵ *Po aty*, dok. nr. 22, 15 prill 1701, f. 66.

Ndërsa taksa konsullore veneciane (il cottimo) në Durrës dhe në portet e tjerë të Shqipërisë vazhdonte të ishte 2% mbi mallrat, prej të cilës, 0.5% përbënte të ardhurat e konsullit të Durrësit, të cilave i shtohej edhe taksa e ankorimit prej 15 realësh, që ai mbliidhte nga anijet e mëdha dhe prej 9 realësh për anijet e vogla⁵⁶.

Bailit venecian iu desh të interesohej gjithashtu për heqjen e një mbitakse (avania) prej 10% mbi kontratat e navllimit (qirave) të anijeve, e cila pretendohet në mënyrë arbitrare nga doganierët dhe rëndonte jo vetëm mbi tregtarët dhe kapitenët e anijeve veneciane, por edhe mbi francezët⁵⁷. Ky dokument do të dërgohej në Durrës me garanci të plotë nëpërmjet dragomanit të konsullatës franceze të Durrësit⁵⁸. Kjo dëshmon se pavarësisht konkurrencës së madhe tregtare ndërmjet Venecies dhe Francës, ekzistonte nganjëherë një ndihmë e ndërsjellë ndërmjet dy konsullatave.

Në nëntor 1700, dukej se konsullata veneciane e Durrësit kishte vënë rregull në portin e Durrësit dhe tregtia kishte marrë rrugën e saj normale⁵⁹.

Por brenda një kohe të shkurtër, ndodhën dy ngjarje tragjike. Dy anije veneciane “Suddito Fedele” e “Santa Croce”, u mbytën në brigjet shqiptare. Anija e parë për shkak të përplasjes me shkëmbinjtë nënujorë gjatë stuhisë, ndërsa e dyta pas një dueli në det me një anije osmane nuk mundi ta vazhdonte udhëtimin për shkak të një çarjeje⁶⁰.

Në dëshminë e mbytjes së anijes “Santa Croce” nga ana e të mbijetuarve të ekuipazhit dhe një tregtari shkodran përpara konsullit të Durrësit, ata përshkruan se ishin sulmuar nga një anije që mendonin se ishte anije pirate nga Tripoli, e cila i kishte goditur duke shkaktuar

⁵⁶ AIH, V-2, “Konsujt e Durrësit”, dok. nr. 32, 7 tetor 1706; ASV, CSM, 1° S., b. 661, 7 tetor 1706.

⁵⁷ *Dokumente mbi Shqipërinë në shekullin XVIII...*, përg. Z. Shkodra, vëll. I, dok. nr. 22, 15 prill 1701, f. 66; Riccardo Predelli, *I libri commemoriali della Repubblica di Venezia*, Regesti, vol. 8, XXX, Cambridge: Cambridge University Press, 2012, dok. nr. 91, gusht 1700, f. 101.

⁵⁸ *Dokumente mbi Shqipërinë në shekullin XVIII...*, përg. Z. Shkodra, vëll. I, dok. nr. 18, 30 janar 1701, f. 62.

⁵⁹ ASV, CSM, 1° S., b. 661, nëntor 1700.

⁶⁰ *Dokumente mbi Shqipërinë në shekullin XVIII...*, përg. Z. Shkodra, vëll. I, dok. nr. 13, 14 nëntor 1700; dok. nr. 14, f. 54 -57, 27 nëntor 1700.

fundosjen e anijes së tyre dhe ishin shpëtuar nga anija veneciane me kapiten Niccolò Moroe⁶¹.

Konsulli i Venecies Giorgio Cumano, duke u bazuar mbi opinionin e tregtarëve të portit të Durrësit, u referonte Pesë të Urtëve, që anijes u ishin dhënë sinjale me anë të zjarrit nga bregdeti i Durrësit dhe se ajo kishte si objektiv vetëm anijen “Santa Croce”⁶². Në veprimet e saj, anija kishte përkrahjen e Mustafa Topçi Bashit, «kryeartiljerit të Durrësit»⁶³.

Në të vërtetë, në qendër të kësaj ngjarjeje ishte grindja ndërmjet parisë së Portës me dy tregtarë voskopojarë⁶⁴.

Si rrjedhojë, qe një humbje e madhe për tregtinë veneciane sepse secila prej anijeve kishte një ngarkesë prej 700-800 dengjesh me lesh.

Konsulli Giorgio Cumano u detyrua që t’i shkruante djemve të Andrea Kotonit nga Arta, të cilët kishin një kompani të madhe në Venecie që merrej me shkëmbime tregtare me Durrësin dhe më gjerë, për faktin se kishin shumë ndikim tek autoritetet veneciane për tregtinë. Në letërkëmbim, ai ia hedh fajin konkurrencës me konsullatën franceze që donte të rrëronte tregtinë veneciane⁶⁵. E gjithë kjo duket një alibi për të justifikuar këtë humbje të madhe⁶⁶. Tregtarët ishin të zhgënjyer sepse autoritetet veneciane nuk i kishin shoqëruar anijet tregtare me sasi të mëdha mallrash me anije patrullë që t’i mbronin nga sulmet në det, megjithëse konsulli venecian i Durrësit e kishte kërkuar me këmbëngulje. Pavarësisht faktit se taksa konsullore veneciane prej 2% ishte parashikuar si një siguracion i pjesshëm për rastet e mbytjes së anijeve tregtare ose të sulmeve ndaj tyre, tregtarët që kishin humbur mallin i drejtoheshin së bashku me konsullin venecian ambasadorit të jashtëzakonshëm në Stamboll. Si rezultat, për dëmet e mëdha që kishte pësuar tregtia, u ngrit një proces gjyqësor kundër Mustafa Topçi Bashit të Durrësit, që të dilnin në shesh përgjegjësitë dhe shkaqet e mbytjes së anijes⁶⁷. Në këtë proces, duhet të merrnin pjesë të gjithë ata që tregonin në portin e Durrësit, të

⁶¹ ASV, CSM, 1° S., b. 661, 14 nëntor 1700; *Dokumente mbi Shqipërinë në shekullin XVIII...*, përg. Z. Shkodra, vëll. I, dok. nr. 13, 14 nëntor 1700, f. 51.

⁶² *Po aty*, dok. nr. 14, 27 nëntor 1700, f. 56-57.

⁶³ Ai përfaqësonte autoritetin më të lartë të Durrësit dhe ishte në varësi të pashait, që e kishte selinë në Kavajë.

⁶⁴ P. Xhufi, *Shekulli i Voskopojes...*, f. 111.

⁶⁵ *Dokumente mbi Shqipërinë në shekullin XVIII...*, përg. Z. Shkodra, vëll. I, dok. nr. 14, 27 nëntor 1700, f. 54 -57.

⁶⁶ *Po aty*.

⁶⁷ *Po aty*, dok. 23, 18 prill 1701, f. 67.

cilët për shkak të murtajës që kishte rënë në qytet, nuk ishin të pranishëm sepse kishin gjetur strehë në fshatrat përreth⁶⁸. Ata u lajmëruan nga konsulli se gjithçka ishte shtyrë dhe duhet të pritnin fundin e epidemisë⁶⁹. Si përfundim, në këtë proces u mor vendimi për djegien e anijes së Mustafa Topçi Bashit⁷⁰.

Në kohën kur konsullata veneciane qëndronte e mbyllur, shtetet e tjera kishin punësuar në administratën e tyre konsullore njerëz që kishin qenë më parë kandidatë për postin e konsujve në atë konsullatë. Po ashtu, edhe tregtarët e këtyre dy vendeve (Shqipërisë dhe Venecies), kontribuonin për zgjerimin e rrjetit tregtar të tyre. Një nga këta ishte Francesco d'Andria, i cili ishte pjesë e personelit të konsullatës franceze të Durrësit duke i krijuar vështirësi lundrimit venecian me episodin e anijes perastine që kishte pranuar të ndërronte flamurin⁷¹. Kjo e shtyu Senatin që të nxirrte një ligj më 21 gusht 1700 për anijet veneciane që të respektonin radhën në portin e Durrësit⁷².

Ndër këta njerëz që e njihnin mirë tregtinë veneciane, ishte dhe vëllai i Iseppo Vellai-t, një kandidat tjetër rival gjatë zgjedhjes së Giorgio Cumanos, i cili kishte mbështetjen e konsullatës raguzane dhe franceze në Durrës. Megjithatë, konsulli venecian kishte mundur ta tërhiqte atë pranë konsullatës veneciane⁷³.

Ndërmjet familjeve Cumano e Vellai ekzistonin lidhje miqësore, por edhe rivalitet për postin e konsullit venecian të Durrësit. Iseppo Vellai kishte qenë gjithashtu përpara vitit 1699 kreditor i konsullatës franceze dhe raguzane në Durrës dhe nuk i ishin kthyer plotësisht kreditë⁷⁴. Ky fakt do të përdorej më vonë nga Giorgio Cumano për t'u mbrojtur nga pretendimet e Iseppo Vellai-t për postin e konsullit venecian të Durrësit, i cili do t'i shkruante Pesë të Urtëve se gjoja Iseppo përkrahte rrugën tregtare Durrës-Ankonë-Raguzë dhe mbështeste konsujt e tjerë.

⁶⁸ *Po aty*.

⁶⁹ *Po aty*.

⁷⁰ *Po aty*, dok. nr. 39, 27 prill 1702.

⁷¹ *Dokumente mbi Shqipërinë në shekullin XVIII...*, përg. Z. Shkodra, vëll. I, dok. nr. 9, 11 nëntor 1700, f. 44.

⁷² *Po aty*, dok. nr. 5, viti 1700, f. 35-36.

⁷³ *Po aty*, dok. nr. 6, 6 tetor 1700, f. 36-37.

⁷⁴ *Po aty*, dok. nr. 23, 18 prill 1701, f. 68; A. Saraçi, *Tregtia adriatike e Shkodrës...*, f. 192.

Pikërisht, në këtë periudhë del në skenë, rasti më tipik i rivalit të tregtisë veneciane, Nicola Pulimeno nga Janina, i cili kishte marrë postin e konsullit të Holandës në Durrës në kapërcyell të shek. XVII dhe XVIII, që mbahej më parë nga një konsull holandez⁷⁵. Ai kishte qenë një nga kandidatët për postin e konsullit venecian të Durrësit dhe e kishte humbur sfidën me Giorgio Cumano-n.

Qëllimi i konsullit Pulimeno ishte të stimulonte tregtinë holandeze, duke i kundërvënë rrugës tregtare Durrës - Venecia, rrugën tregtare Durrës - Ankonë - Raguzë, e cila e dëmtonte tregtinë veneciane, duke i ndërruar drejtimin fluksit të mallrave⁷⁶.

Nicola Pulimeno kishte në dispozicion një anije polake, ndërsa konsullata franceze kishte tri anije (tartana), një nga të cilat e kishte ndërtuar në Durrës⁷⁷. Sipas njoftimeve të Giorgio Cumanos drejtuar Pesë të Urtëve, këto anije ishin të mjaftueshme për transportin e mallrave në Durrës dhe po i bënë një konkurrencë të madhe dy anijeve (fregandonë) veneciane në pritje për ardhjen e mallrave.

Konkurrenca ishte e dukshme edhe përse i përket tërheqjes së tregtarëve dhe mallrave nga konsujt drejt konsullatave të tyre. Konsulli Nicola Pulimeno i kishte shkruar tregtarëve të portit të Durrësit dhe kishte mundur t'i bindte që t'i dërgonin mallrat nëpërmjet konsullatës holandeze⁷⁸.

⁷⁵ *Dokumente mbi Shqipërinë në shekullin XVIII...*, përg. Z. Shkodra, vëll. I, dok. nr. 2, 10 prill 1700, f. 32-33; P.C. Mason, *Histoire du commerce français...*, f. 122; Hermann Wätjen, *Die Niederlander in Mittlemeergebiet zur Zeit ihrer höchsten Machtstellung*, Berlin: Karl Curtius, 1909, f. 109. Gjatë gjysmës së parë të shek. XVII, tregtia holandeze drejtohej nga Parlamenti i Pesë Provincave të Bashkuara (Staten-Generaal), derisa ai votoi për ngritjen e një Dhome të Drejtimit me seli në Amsterdam, e cila quhej edhe Kompania Holandeze e Lindjes, që menaxhonte tregtinë dhe lundrimin në Mesdhe, e cila emëronte me ndihmën e Parlamentit stafin e konsullatave të Lindjes dhe zgjidhte çështjet mes tregtarëve. Konsullata holandeze në vendet e Mesdheut mund të përfaqësohej jo vetëm nga konsuj holandezë, por edhe nga të huaj që kishin lindur ose jetonin në këto vende ndër të cilët: francezë, venecianë dhe grekë ose nga konsullata të tjera të huaja.

⁷⁶ Përse i përket rrugës që ndiqnin mallrat nga Ankona drejt Vendeve të Ulëta shih: Wilfrid Brulez, "L'Exportation des Pays-Bas vers l'Italie par voie de terre, au milieu du XVI^e siècle", në *Annales. Économies, societies, civilisations*, 14^e année, nr. 3, Paris: Armand Colin, 1959, f. 469.

⁷⁷ *Dokumente mbi Shqipërinë në shekullin XVIII...*, përg. Z. Shkodra, vëll. I, dok. nr. 19, 12 shkurt 1702, f. 63-64.

⁷⁸ *Po aty*.

Në letërkëmbimin e tij, konsulli venecian i Durrësit ishte pesimist për gjendjen e krijuar dhe mendonte se amullia në tregtinë veneciane do ta detyronte atë që ta braktiste portin⁷⁹. Madje, ai i kërkonte autoriteteve veneciane ndonjë mënyrë për ta larguar nga Durrësi, Pulimenon⁸⁰.

E vetmja mënyrë për t'i bërë ballë konkurrencës për Giorgio Cumano-n ishte gjetja e alternativave me ndihmën e Pesë të Urtëve. Një ndër to ishte lidhja e kontratave lidhur me qiramarrjen e anijeve për transportin e mallrave me çmime më të ulëta, si në rastin e kontratave ndërmjet kapitenëve perastinë me tregtarët e Siatistës⁸¹.

Gjithashtu, përsa i përket kontratave që lidheshin ndërmjet tregtarëve dërgues nga Shqipëria dhe korrespondentëve të tyre në Venecie për dërgimin e mallrave, meqenëse ato porositeshin, Pesë të Urtët nuk do të lejonin që korrespondentët t'ia porositin mallrat konsullit të Holandës në Durrës⁸².

Sipas ligjeve veneciane të tregtisë, konsulli dhe nënkonsulli venecian nuk duhet të merreshin me tregti, por të ndiqnin mbarëvajtjen e shkëmbimeve tregtare⁸³. Ndërsa konsulli francez dhe holandez mund të merreshin me tregti dhe pozicioni i tyre i jepte mundësi që ta zgjeronin edhe tregtinë e tyre. Sipas raportit të konsullit venecian, konsulli francez dhe ai holandez në Durrës ishin pjesë e një kompanie në ortaki për tregtimin e veshjeve dhe pëlhurave londrinë të prodhimit francez dhe flaming nga Ankona në Durrës⁸⁴. Kjo kompani kishte si qëllim futjen e këtyre mallrave të importit në tregun shqiptar dhe ballkanik, duke i bërë konkurrencë prodhimeve veneciane. Kjo nënkuptonte se Franca dhe Holanda kishin interesa ekonomikë të përbashkët. Dy anije (felukë) franceze që arrinin nga Franca me mesazhet diplomatike (i dispacci) për në Stamboll, transportonin gjithashtu edhe veshjet prej leshi londrinë franceze dhe flanginge për kompaninë franko-holandeze të Pulimenos⁸⁵.

⁷⁹ *Po aty*.

⁸⁰ *Po aty*, dok. nr. 33, 12 dhjetor 1701, f. 81.

⁸¹ *Po aty*, dok. nr. 31, 1 nëntor 1701, f. 77-78.

⁸² *Po aty*, dok. nr. 33, 12 dhjetor 1701, f. 81.

⁸³ N. Steensgaard, "Consuls and nations...", f. 25.

⁸⁴ ASV, CSM, 1° S., b. 661, 6 tetor 1700; *Dokumente mbi Shqipërinë në shekullin XVIII...*, përg. Z. Shkodra, vëll. I, dok. nr. 6, 6 tetor 1700, f. 37.

⁸⁵ *Dokumente mbi Shqipërinë në shekullin XVIII...*, përg. Z. Shkodra, vëll. I, dok. nr. 19, 12 shkurt 1702, f. 63-64.

Sipas letërkëmbimit ndërmjet tregtarëve të Voskopojës dhe Pesë të Urtëve, konsulli francez dhe holandez kishin nën kontroll edhe portin e Durrësit dhe u kërkonin në mënyrë arbitrare taksën e baxhit ose të tranzitit “la tassa del capitano”, anijeve që arrinin nga Venecia në doganën e Durrësit⁸⁶. Por, kjo taksë u hoq me ndihmën e ambasadorit të jashtëzakonshëm të Venecies në Stamboll, Lorenzo Soranzo, i cili në dritën e marrëveshjeve dypalëshe kishte mundur të nxirrte një *berat* që mbante firmën e Sulltanit dhe i drejtohej kadiut të Durrësit⁸⁷.

Për të penguar tregtinë me Venecien, Nicola Pulimeno krijoi raporte të mira me autoritetet lokale e doganierët dhe i këshilloi ata që si shtetas të Perandorisë Osmane të mos i ndiqnin ligjet e tregtisë veneciane⁸⁸. Ai e kishte përfshirë edhe anijen e Mustafa Topçi Bashit, që quhej “Ylli i Mëngjesit - Stella Matuttina” me kapiten Mehmet Berin*, ekuipazhi i së cilës ishte ulqinak dhe përbëhej nga katër marinarë raguzanë, në tregtinë franko-holandeze⁸⁹. Pulimeno donte të zhvillonte me anë të kësaj anijeje tregtinë me Venecien, ndaj i bindi tregtarët e Elbasanit, Manastirit, Siatistës dhe të Voskopojës që tregtonin në portin e Durrësit që t’i nisnin mallrat drejt Venecies me anijen e lartpërmendur dhe të mos praninin transportin me anije perastine. Qe kjo ndoshta arsyeja që e nxiti kapitenin perastin Marco Stucanovich natën e 22 marsit 1702 për të sulmuar anijen, të cilën e rrëmbeu bashkë me të gjithë mallrat⁹⁰. Sipas letërkëmbimit francez, ai u largua bashkë me anijen në Otranto dhe francezët bënë përpjekje për ta rikuperuar atë⁹¹.

Edhe në të kaluarën kishin ekzistuar fërkime ndërmjet marinarëve perastinë dhe atyre të anijeve që zhvillonin transportin për konsullatat e

⁸⁶ ASV, CSM, 2° S., b. 28, 30 gusht 1701; shih “Hyrjen” në *Dokumente mbi Shqipërinë në shekullin XVIII...*, përg. Z. Shkodra, f. 16.

⁸⁷ *Dokumente mbi Shqipërinë në shekullin XVIII...*, përg. Z. Shkodra, dok. nr. 27, f. 74-75, përkthim nga italishtja i beratit, 20 gusht 1701; R. Predelli, *I libri commemoriali...*, vol. 8, dok. nr. 91, gusht 1700, f. 101.

⁸⁸ ASV, CSM, 1° S., b. 662 (1712-1738), viti 1705. Relacion i konsullit venecian Pietro Rosa drejtuar Pesë të Urtëve lidhur me tregtinë në portin e Durrësit; Valeriu Papahagi, *Aromâni Moscopoleni Și Commerțul Venețian in sec. al XVII-lea si al XVIII-lea*, București: Editura Societății de Cultură Macedo-Română, 1935, f. 97-98.

* Në dokumentet e tjera emri i kapitenit shfaqet si Ahmet Beri.

⁸⁹ *Po aty*.

⁹⁰ *Dokumente mbi Shqipërinë në shekullin XVIII...*, përg. Z. Shkodra, vëll. I, dok. nr. 36, 23 mars 1702, f. 85.

⁹¹ *Po aty*, dok. nr. 38, 31 mars 1702, f. 87.

tjera për shkak të konkurrencës. Pak kohë më parë, Giorgio Cumano i kishte informuar Pesë të Urtët se vëllai i tij, i kishte bërë thirrje marinareve të një anijeje perastine që të tërhiqeshin nga sulmi ndaj një anijeje që po ngarkohej për llogari të konsullatave të huaja⁹².

Në këtë mënyrë, konsullit francez dhe holandez iu dha rasti që të krijonin një krisje ndërmjet Venecies dhe autoriteteve të Durrësit, duke e vënë në krizë tregtinë veneciane. Megjithatë, ata nuk mund ta mbyllnin krejtësisht tregtinë e Venecies me Durrësin, sepse gjithçka ishte përcaktuar nga kapitulacionet dhe marrëveshjet dypalëshe ndërmjet Venecies dhe Stambollit.

Dy konsujt e kishin shfrytëzuar dëmin që u ishte bërë tregtarëve dhe anijes, që të përdornin të gjitha mënyrat, madje edhe para, për t'i vënë venecianët që gjendeshin në portin e Durrësit në bankën e të akuzuarit. Ndikimi i tyre përfshiu doganierin dhe arriti deri tek tregtarët e Elbasanit, Manastirit, Siatistës e Voskopojës, të cilët i ishin drejtuar kadinjve të Elbasanit dhe të Durrësit duke akuzuar padrejtësisht edhe vetë konsullin e Venecies, Giorgio Cumano se kishte qenë ai që e kishte shtyrë Stucanovich-in që të sulmonte anijen për faktin se ata e kryenin transportin e mallrave me anije ulqinake⁹³. Çështja e tyre arriti deri tek veziri me origjinë shqiptare, Hysen Köprülü (Koprili) që ta zgjidhte atë me Bailin venecian në Stamboll, të cilit ai i kërkoi që anija me mallra të kthehej në Durrës⁹⁴.

Ndërkohë, në portin e Durrësit ishte krijuar një gjendje alarmi ndërmjet perastinëve dhe ulqinakëve. Gjithashtu, ishin acaruar marrëdhëniet e Venecies me autoritetet lokale të Durrësit, të cilat kishin arritur *in extremis*, sepse ato kishin urdhëruar që të mos lejoheshin perastinët që të zbrisnin në breg dhe po mendonin që t'i largonin anijet veneciane nga porti i Durrësit⁹⁵. Kjo situatë kishte bërë që autoritete të larta të marinës veneciane të niseshin drejt Durrësit për të zgjidhur çështjen. Qëndrimi i doganierit shqiptar ndryshoi papritmas dhe ai u distanca nga Pulimeno. Kjo për shkak se Pulimeno, i cili mori në dorë

⁹² *Po aty*, dok. nr. 19, 12 shkurt 1702, f. 63-64.

⁹³ C. Luca, "The dynamics of the Commercial Activity...", f. 181-182; *Dokumente mbi Shqipërinë në shekullin XVIII...*, përg. Z. Shkodra, vëll. I, dok. nr. 37, 25 mars 1702, f. 86.

⁹⁴ ASV, BC, Lettere, b. 167, Adrianopojë, 17 prill 1702.

⁹⁵ *Dokumente mbi Shqipërinë në shekullin XVIII...*, përg. Z. Shkodra, vëll. I, dok. nr. 38-39, 27 prill 1702.

letrën e autoritetit venecian për ta përkthyer, tha të kundërtën e asaj që ajo përmbante. Madje, sjellja e tij e shtyu doganierin që t'i tregonte konsullit venecian të vërtetën lidhur me akuzat dhe që të shprehej i gatshëm që anijet perastine të vazhdonin tregtinë si më parë. Pra, u krijua një situatë e tillë *boomerangu* që i rregulloi marrëdhëniet e Venecies me autoritetet e Durrësit. Kështu, iu hap rruga bisedimeve të drejtpërdrejta ndërmjet autoriteteve veneciane të marinës dhe autoriteteve të Durrësit.

Situata paraqitej e favorshme për venecianët dhe impakti mbi tregtinë do të ishte pozitiv. Konsulli i Venecies, Giorgio Cumano, i cili dinte gjithçka, kishte çfarë t'i shpjegonte ambasadorit venecian në Stamboll, Lorenzo Soranzo lidhur me çështjen. Jo vetëm që pengesat që kishte hasur tregtia po tejkaloheshin, por konsulli kishte mundësi që të dëshmonte pafajësinë e tij përpara autoriteteve veneciane.

Megjithatë, për zgjidhjen e plotë të çështjes duhej një kohë më e gjatë. Senati venecian caktoi proveditorin Marino Zane që të merrej me zhdëmtimin e tregtarëve dhe anija e braktisur nga Marco Stucanovich, u sekuestrua dhe u shit së bashku me mallrat, për të siguruar shumat e nevojshme. U vendos që tregtarëve t'u ktheheshin 75% të vlerës së mallit të deklaruar në doganë⁹⁶.

Pati edhe momente të tjera të vështira për konsullin e Venecies në Durrës. Tregtarët e Shkodrës, qytet me një tregti në rritje, në vitin 1702 iu drejtuan Pesë të Urtëve duke u kërkuar zëvendësimin e konsullit Giorgio Cumano me Iseppo Vellai-n⁹⁷. Në fakt, Pesë të Urtët u kishin dhënë tregtarëve të Shkodrës një peshë të madhe në zgjedhjen e konsullit venecian të Durrësit, duke shprehur preferencat e tyre në lidhje me kandidatët për këtë post.

Por në gusht 1702, duket se konsullata veneciane, franceze, holandeze dhe raguzane i lanë pas kontradiktat që kishin ndërmjet tyre⁹⁸.

Si përfundim, distanca e afërt e Durrësit me Venecien në Adriatik dhe rënia e tregtisë në portin tranzit të Splitit, nxori në pah në gjysmën e dytë të shek. XVII Durrësin si qendër tregtare dhe Shqipërinë, sepse nga porti i Durrësit mund të transportoheshin drejt Venecies mallra që vinin nga i gjithë Ballkani. Së dyti, në Mesdhe do të mbizotëronin anijet tregtare angleze, franceze dhe holandeze, dhe po në këtë periudhë do të

⁹⁶ Grigore Arbore Popescu, Cristian Luca, *Venezia e l'Europa Orientale tra il Tardo Medioevo e Età Moderna*, Treviso: Antiga edizioni, 2017, f. 17.

⁹⁷ *Po aty*; ASV, CSM, 2°S., b. 28, 21 gusht 1702.

⁹⁸ *Po aty*.

ngriheshin konsullata e Francës dhe e Holandës në Durrës, gjë që do ta kthente këtë qytet në një udhëkryq të tregtisë ndërkombëtare. Së treti, mallrat shqiptare dhe ato ballkanase ishin të cilësisë së lartë dhe kishin rëndësi për industrinë e Venecies. Së katërti, në shkëmbimet tregtare kishte peshë ndikimi i diasporës shqiptare dhe raportet me kompanitë tregtare e panairot ballkanike etj. Venecia do të gjendej gjithashtu përballë lundrimit të zhvilluar dhe anijeve tregtare të Ulqinit, të cilat do të kishin peshën e tyre edhe në raportet tregtare, gjë që dëshmonte se venecianët nuk e kishin kontrollin e plotë të Adriatikut.

S u m m a r y

THE ROLE OF THE VENETIAN CONSULATE OF DURRËS IN PROTECTING VENICE'S ECONOMIC INTERESTS IN THE BEGINNING OF THE XVIII CENTURY

During the second half of the XVIIth Century, a Venetian consulate was set up at Durazzo that had its jurisdiction over la scala dell'Albania that included the Albanian ports from Bar (Antivari - Tivar) to Saiada (Sajadha). At the same period, the French and the Dutch opened their consulates at Durazzo. Thus, Durazzo became a crossroads of wares from all over the Balkans. In fact, the trade authority of Cinque Savi alla Mercanzia stated that as far as it concerns the Ottoman Empire only Durazzo and Smirne (Izmir) showed very promising for the Venetian trade.

After the end of the Morean War (1684-1699) and the Treaty of Carlowitz (Sremski Karlovci, 16-26 janar 1699) trade between Venice and Albania resumed and the Cinque Savi alla Mercanzia elected Giorgio Cumano (1700-1702) as the Venetian consul of Durazzo. From the beginning of XVIIIth century, he had to face the competition of the French, Dutch and Ragusan consulates that had employed former Venetian consuls and candidates for the vacant Venetian consular post of Durazzo such as Andrea d'Andria and Nicola Pulimeno, who had become the Dutch consul of Durazzo. The competition included also the direction of the flow of goods, the relationship of the consuls with the merchants and the local authorities or the differences between Perastine and Dolcignotte (Ulqin –Ulcinj) Navigation.